



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONIERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23.3.2023

Nr: 193

Ora: 11:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOALICIONIT "ALEANCA", (AL), PËR ZGJEDHJET PËR
ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 14 MAJ 2023**

Sot më datë, 23.3.2023 në seancë publike, mora në shqyrtim marrëveshjen me nr.1670, datë 15.03.2023 me:

Kërkues: Aleanca Demokratike e Shqipërisë , "Aleanca për Drejtësi dhe Solidaritet", " Aleanca për Barazi dhe Drejtësi Europiane".

Objekti: Regjistrimi i koalicionit "ALEANCA" AL, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023

Baza ligjore: Neni 65 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar

Në përfundim të shqyrtimit administrativ

V Ë R E J:

Presidenti i Republikës, me Dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, ka caktuar datën 14 maj 2023, si datën e zhvillimit të zgjedhjeve për organet e qeverisjes vendore.

Koalicioni Zgjedhor "ALEANCA" AL, ka depozituar pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve marrëveshjen për krijimin e koalicionit, në të cilën është shprehur vullneti i partive të sipërpërmendura për të qenë pjesëmarrëse të këtij koalicioni.

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, marrëveshja me nr 1670 prot, datë 15.03.2023 në KQZ, nuk përmush kriteret e përcaktuara në nenin 65 të Kodit Zgjedhor.

Data: 23.3.2023 Nr: 193
Ora: 11:00



"Për shqyrtimin e kërkesës për regjistrimin e koalicionit "ALEANCA",AL, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023".

Në seancën publike të datës 20.03.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve i ka lënë afat 48 orë Aleancës AL, për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për regjistrimin e Koalicionit si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj 2023.

Në seancën publike të datës 23.03.2023, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve në përfundim të afatit 48 orë, konstatoi se “Aleanca” AL, nuk e ka përmbushur detyrimin për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm, për tu regjistruar si subjekt zgjedhor në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore që do të zhvillohen më datë 14 maj.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, 65 e 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Mos regjistrimin e Koalicionit “ALEANCA” AL, si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 maj 2023.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen elektronike zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI